



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 100

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E premte, 14 qershor 2024

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 376, datë 12.6.2024	Për transferimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes tek Bashkia Klos, të pronës nr. 718, me emërtimin “Ish-grup-depo armatim- municion”, Klos, me vendndodhje në zonat kadastrale 1137 e 2164, dhe për disa ndryshime në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, e për një shtesë në vendimin nr. 1099, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave.....	10831
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 379, datë 12.6.2024	Për një ndryshim dhe një shtesë në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar.....	10834
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 380, datë 12.6.2024	Për miratimin e marrëveshjes shtesë të financimit të marrëveshjes së financimit, të datës 28 mars 2018, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (marrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW, Frankfurt Am Main (KfW), për projektin “Fondi për arsimin dhe formimin profesional (AFP) dhe punësimin: Qendra Shumëfunksionale në Kamzë”, miratuar me vendimin nr. 330, datë 6.6.2018, të Këshillit të Ministrave.....	10841
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 381, datë 12.6.2024	Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e miratuar për vitin 2024, ndërmjet programeve të Ministrisë së Drejtësisë.....	10844
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 382, datë 12.6.2024	Për miratimin e protokollit të parë, për zbatimin e marrëveshjes, për kushtet për akses të lirë në tregun e punës në Ballkanin Perëndimor....	10844
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 383, datë 12.6.2024	Për përcaktimin e rregullave më të detajuara për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Komisionit të Objekteve të Konfiskuara.....	10849
Urdhër i ministrit të Financave nr. 75, datë 7.6.2024	Për ngarkim të përkohshëm/zëvendësim në detyrë.....	10852

Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 123, datë 5.6.2024	Për miratimin e planit vjetor minerar 2024.....	10852
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 319, datë 10.6.2024	Për disa ndryshime në urdhrin nr. 432, datë 30.6.2023, të ministrit të Drejtësisë “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për organizimin, zhvillimin, përmbajtjen e provimit të pranimi, si dhe procedurën e vlerësimit dhe shpalljes së rezultateve për përmbaruesin gjyqësor shtetëror”.....	10835
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 9035, datë 11.6.2024	Mbi hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje dypalëshe.....	10856
Urdhër i Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 91, datë 11.6.2024	Për delegim të përkohshëm kompetencash.....	10856
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë nr. 41-2024-1137-323, datë 28.3.2024	Për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Ada Lako.....	10856

**VENDIM****Nr. 376, datë 12.6.2024**

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI,
NGA MINISTRIA E MBROJTJES TEK
BASHKIA KLOS, TË PRONËS NR. 718,
ME EMËRTIMIN “ISH-GRUP-DEPO
ARMATIM-MUNICION”, KLOS, ME
VENDNDODHJE NË ZONAT
KADASTRALE 1137 E 2164, DHE PËR
DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR, E
PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN
NR. 1099, DATË 30.7.2008,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes tek Bashkia Klos, të pronës nr. 718, me emërtimin “Ish-grup-depo armatim-municion”, Klos, me vendndodhje në zonat kadastrale 1137 e 2164, sipas formularit dhe plan-rilevimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi, me qëllim për ta përdorur për realizimin e funksioneve në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.

2. Në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, në listën e inventarit, bashkëlidhur vendimit, përmasat e pronës nr. 718, me emërtimin “Ish-grup-depo armatim-municion”, Klos, zëvendësohen me përmasat e përcaktuara në formularin dhe plan-rilevimin, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

3. Prona nr. 718 hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar.

4. Prona e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, i shtohet listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 1099, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në Bashkinë Klos, të qarkut të Dibrës”.

5. Bashkisë Klos i ndalohet ndryshimi i destinacionit dhe tjetërsimi i pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

6. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Bashkia Klos dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**



FORMULARI I PËRDITËSIMIT TË PRONËS

Institucioni Qendror Shtetëror MINISTRIA E MBROJTJES		Identifikoi pronën		Kapiten Reldion Kole / Specialist i Infrastrukturës i Forcës Tokësore (Emri, Mbiemri, Pozicioni Zyrtar)								
Supervizoi		Nënkolonel Revis Xhepa / Shef i Degës Logjistike i Forcës Tokësore (Emri, Mbiemri, Pozicioni Zyrtar)										
Aprovoi		Gjeneralmajor Ilir Xhebeti / Komandant i Forcës Tokësore (Emri, Mbiemri, Pozicioni Zyrtar)										
Nr.	Zona Kadastrale Indeksi i Hartës	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Emërtesa e Pasurisë Adresa	Sip. e pasurisë (m2)	Nga sip		Institucioni me funksionin që përdoret administrative / pronësi	Institucioni përdorues i pronës Statusi juridik i përdorimit	Inventarizuar me VKM	Të dhëna të tjera	
	Truall (m2)	Ndërtesë (m2)	Për mbrojtjen	Ministria e Mbrojtjes	Komanda e Forcës Tokësore (Rep. Ushtrarak Nr.1001 Rep. Ushtrarak Nr.1013)	VKM Nr. 515 datë 18.07.2003, i ndryshuar me VKM 737/2012						
	1137 K-34-89- (132-A)	40/17-A	Truall ndërtesë	Ish Grup Depo Armatim- Municion, Klos, Burrel	Objekti Nr.1 - Depo veshmbathje	13328	13328	412,92				Ndodhet një objekt informal
	1137	40/15-A	Truall	Truall funksional	Truall funksional	4594	4594					
	1137	40/15-C	Truall	Truall funksional	Truall funksional	3365	3365					Ndodhet një objekt informal
2164	127/11-A	Shkëmbore	Truall funksional	Truall funksional	391	391						
Total						21678	21678	412,92				

718



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE Prona nr.718 " Grup Depo AM" Klos, Mat																																	
PRONARI: REPUBLIKA E SHQIPËRISË (MM)	DATË 25/03/2024	QËLLIMI Përditësim, Regjistrim																															
VENDNDODHJA Bashkia <u>Klos</u> ZVASHK <u>Mat</u> Nr.Pasurisë <u>40/15, 40/17, 127/11</u> Z.K <u>1137, 2164</u> Indeksi i Hartës <u>K-34-89-(132-A)</u>																																	
TE DHËNAT E PASURISË Lloji i pasurisë _____ Sip e pasurive 53805m² Sip e gjurmës së ndërtimit _____ Nr. kateve <u>1</u> Nr. pemeve _____																																	
Nord =4595962.25 East = 507639.31		Nord =4595962.25 East = 508079.22																															
KORNIZA REFEREUERE GJEODEZIKE SHQIPTARE (KRGJSH)																																	
Shpjeguese:																																	
<table border="0" style="width: 100%;"> <tr> <td style="width: 10%;"></td> <td style="width: 80%;">Kufiri i pronës nr. 718 sipas VKM nr.737, datë 16.10.2012</td> <td style="width: 10%;"></td> </tr> <tr> <td></td> <td>Sip. e pasurisë nr 40/17-A sipas Faktit</td> <td>= 13328m²</td> </tr> <tr> <td></td> <td>Sip. e gjurmës së ndërtimit të objektit nr.1</td> <td>= 412.92m²</td> </tr> <tr> <td></td> <td>Sip. e gjurmës së ndërtimit të objektit informal</td> <td>= 152m²</td> </tr> <tr> <td></td> <td>Sip. e pasurisë nr 40/15-A sipas Faktit</td> <td>= 4594m²</td> </tr> <tr> <td></td> <td>Sip. e pasurisë nr 40/15-C sipas Faktit</td> <td>= 3365m²</td> </tr> <tr> <td></td> <td>Sip. e gjurmës së ndërtimit të objektit informal</td> <td>= 76m²</td> </tr> <tr> <td></td> <td>Sip. e pasurisë nr 127/11-A sipas Faktit</td> <td>= 391m²</td> </tr> <tr> <td colspan="3"> Sip. e Përgj. sipas faktit e pasurive me nr. 40/17-A+ 40/15-A+ 40/15-C+127/11-A = 21678m² </td> </tr> <tr> <td colspan="3"> Sip. e gjurmës së ndërtimit të objektit nr 1= 412.92m² </td> </tr> </table>					Kufiri i pronës nr. 718 sipas VKM nr.737, datë 16.10.2012			Sip. e pasurisë nr 40/17-A sipas Faktit	= 13328m ²		Sip. e gjurmës së ndërtimit të objektit nr.1	= 412.92m ²		Sip. e gjurmës së ndërtimit të objektit informal	= 152m ²		Sip. e pasurisë nr 40/15-A sipas Faktit	= 4594m ²		Sip. e pasurisë nr 40/15-C sipas Faktit	= 3365m ²		Sip. e gjurmës së ndërtimit të objektit informal	= 76m ²		Sip. e pasurisë nr 127/11-A sipas Faktit	= 391m ²	Sip. e Përgj. sipas faktit e pasurive me nr. 40/17-A+ 40/15-A+ 40/15-C+127/11-A = 21678m²			Sip. e gjurmës së ndërtimit të objektit nr 1= 412.92m²		
	Kufiri i pronës nr. 718 sipas VKM nr.737, datë 16.10.2012																																
	Sip. e pasurisë nr 40/17-A sipas Faktit	= 13328m ²																															
	Sip. e gjurmës së ndërtimit të objektit nr.1	= 412.92m ²																															
	Sip. e gjurmës së ndërtimit të objektit informal	= 152m ²																															
	Sip. e pasurisë nr 40/15-A sipas Faktit	= 4594m ²																															
	Sip. e pasurisë nr 40/15-C sipas Faktit	= 3365m ²																															
	Sip. e gjurmës së ndërtimit të objektit informal	= 76m ²																															
	Sip. e pasurisë nr 127/11-A sipas Faktit	= 391m ²																															
Sip. e Përgj. sipas faktit e pasurive me nr. 40/17-A+ 40/15-A+ 40/15-C+127/11-A = 21678m²																																	
Sip. e gjurmës së ndërtimit të objektit nr 1= 412.92m²																																	
Nord =4595611.18 East = 507639.31		SH 1: 2500 METRA																															
NR. ORIENTIMI PERDORIMI TIPI I KUFIRIT KUFITARI		ID/NIPT																															
1 Veri		K51726024H																															
2 Lindje		3 Jug																															
4 Perendim		5																															
REALIZOI PËR IGJIU Ing. Eris Ndrukaj		TEKNOLOGJIA E MATJEVE Z-Zyrë; O-Ortofoto. PËRCAKTIMI I KUFIRIT: Sipas dokumentacionit hartografik arkivor, HTR. Shënim: Ky plan rilevimi u hartua në zbatim të shkrësës të Komandës të FT nr.438/1, datë 23.01.2024. Bazuar në dokumentacionin hartografik marrë në arkivin e IGJIU-s, HTR-së dhe kartelat e pasurive , azhromimit në terren në b/punim me përfaqësuesit e FT, ortofoto e vitit 2015-2016.																															
KONFIRMOI PËR IGJIU DREJTORI March. Teuta KANXHERI		PRONARI: REPUBLIKA E SHQIPËRISË, MM (Forca Tokësore) MIRATOHET KOMANDANTI I FORCËS TOKËSORE Gjeneral Major Ilir XHEBEXHIA																															
REALIZOI PËR ASHK Specialisti DVASHK Nënshkrimi KONFIRMOI Përgjegjësi/Drejtori Nënshkrimi/ Vula																																	

**VENDIM****Nr. 379, datë 12.6.2024**

**PËR NJË NDRYSHIM DHE NJË SHITESË
NË VENDIMIN NR. 1128, DATË 30.12.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
ZBATIMIN NGA REPUBLIKA E
SHQIPËRISË TË VENDIMEVE TË
KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN
PËR VENDOSJEN, NDRYSHIMIN DHE
SHFUQIZIMIN E MASAVE
SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE, TË
NDRYSHUARA”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 3, shkronja “c”, e 6, pikat 2 e 5, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 34, e kreut I, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“34. Vendimin e Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2023/1532, në lidhje me masat kufizuese, në funksion të mbështetjes ushtarake të Iranit ndaj luftës së agresionit të Rusisë kundër Ukrainës dhe të grupeve e subjekteve të armatosura në Lindjen e Mesme dhe rajonin e Detit të Kuq, të ndryshuar me vendimet e Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2023/2792, (CFSP) 2024/1336, sipas aneksit 34, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

2. Në aneksin 34, bashkëlidhur vendimit, shtohet vendimi (CFSP) 2024/1336, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**



2024/1336

15.5.2024

VENDIM I KËSHILLIT (CFSP) 2024/1336

i datës 14 maj 2024

ndryshimi i Vendimit (CFSP) 2023/1532 në lidhje me masat kufizuese në funksion të mbështetjes ushtarake të Iranit për luftën e agresionit të Rusisë kundër Ukrainës

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Politikën e Punëve të Jashtme dhe të Sigurisë,

Ndërsa:

- (1) Më 20 korrik 2023, Këshilli miratoi Vendimin (CFSP) 2023/1532 ⁽¹⁾.
- (2) Në konkluzionet e tij të 21 dhe 22 marsit 2024, Këshilli Evropian deklaroi se qasja e Rusisë në artikujt dhe teknologjitë e ndjeshme me rëndësi në fushën e betejës duhet të kufizohet në masën maksimale të mundshme, duke përfshirë shënjestrimin e subjekteve në vendet e treta që mundësojnë anashkalimin e sanksioneve. Këshilli Evropian i bëri thirrje Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Politikën e Punëve të Jashtme dhe Sigurisë ("Përfaqësuesi i Lartë") dhe Komisionit për të përgatitur sanksione të mëtejshme kundër Bjellorusisë, Koresë së Veriut dhe Iranit. Për më tepër, Këshilli Evropian deklaroi se Bashkimi Evropian do të vazhdojë të punojë intensivisht me partnerët rajonalë dhe ndërkombëtarë për të parandaluar përshkallëzimin e mëtejshëm rajonal, veçanërisht në Liban dhe Detin e Kuq. Këshilli Evropian u bëri thirrje të gjithë aktorëve, veçanërisht Iranit, që të përmbahen nga veprimet përshkallëzuese.
- (3) Më 14 prill 2024, në deklaratën e Përfaqësuesit të Lartë në emër të Unionit, Unioni dënoi në mënyrën më të ashpër sulmet me dron dhe raketa iraniane kundër Izraelit më 13 prill 2024 si një përshkallëzim të paprecedentë dhe një kërcënim për sigurinë rajonale.
- (4) Në konkluzionet e tij të 17 prillit 2024, Këshilli Evropian dënoi fuqishëm dhe pa mëdyshje sulmin iranian ndaj Izraelit dhe përsëriti solidaritetin e tij të plotë me popullin e Izraelit dhe angazhimin për sigurinë e Izraelit dhe për stabilitetin rajonal. Këshilli Evropian i bëri thirrje Iranit dhe përfaqësuesve të tij që të ndërpresin të gjitha sulmet dhe u kërkoi të gjitha palëve të ushtrojnë përmbajtjen maksimale dhe të përmbahen nga çdo veprim që mund të rrisë tensionet në rajon. Për më tepër, konkluzionet e Këshillit Evropian deklaruan se Bashkimi do të merrte masa të mëtejshme kufizuese kundër Iranit, veçanërisht në lidhje me mjetet ajrore pa pilot (UAV) dhe raketat. Së fundi, Këshilli Evropian përsëriti se Bashkimi mbetet plotësisht i përkushtuar për të kontribuar në de-përshkallëzimin dhe sigurinë në rajon.
- (5) Rusia po përdor UAV të prodhuara nga Irani në mbështetje të luftës së saj të agresionit kundër Ukrainës, e cila çënon sovranitetin, pavarësinë dhe integritetin territorial të atij vendi, duke përfshirë kundër civilëve dhe infrastrukturës civile. Prandaj, programi i sponsorizuar nga shteti iranian për zhvillimin dhe prodhimin e UAV-ve kontribuon në shkeljet e Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe të parimeve themelore të së drejtës ndërkombëtare.
- (6) Bashkimi është jashtëzakonisht i shqetësuar për raportet se Irani mund të transferojë raketa në Rusi për t'i përdorur në luftën e tij të agresionit kundër Ukrainës.
- (7) Përhapja e UAV-ve dhe raketave të prodhuara nga Irani dhe teknologjive të lidhura me grupet e armatosura joshitetore në Lindjen e Mesme dhe më gjerë është një çështje qendrore shqetësuese. Irani ka transferuar UAV dhe raketa të prodhuara nga Irani te grupet dhe entitetet e armatosura, duke përfshirë Hamasin, Hezbollahun, Houthis dhe milicët në Siri dhe Irak, si dhe te palët në konflikt në Sudan.
- (8) Programi i raketave iraniane, i cili bazohet në kompani shtetërore dhe private dhe përfiton nga aftësitë kërkimore vendase, drejtohet nga Ministria e Mbrojtjes dhe Logjistika e Forcave të Armatosura të Iranit dhe Korpusi i Gardës Revolucionare Islamike, që të dyja organet të sanksionuara nga Unioni. Programi i raketave iraniane përfshin prokurimin, zhvillimin, prodhimin dhe transferimin e raketave.
- (9) Irani mban një marrëdhënie të gjatë me grupet dhe entitetet e armatosura në Lindjen e Mesme dhe rajonin e Detit të Kuq, duke përfshirë organizatat terroriste si krahët ushtarakë të Hezbollahut dhe Hamasit, dhe u ka ofruar atyre raketa të prodhuara nga Irani dhe mjete prodhimi.
- (10) Sigurimi i vazhdueshëm i armëve dhe materialeve të lidhura nga Irani për Houthis është në kundërshtim me Rezolutën 2216 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (2015).

⁽¹⁾ Vendimi i Këshillit (CFSP) 2023/1532 i datës 20 korrik 2023 në lidhje me masat kufizuese në funksion të mbështetjes ushtarake të Iranit ndaj luftës së agresionit të Rusisë kundër Ukrainës [OJ L 186, 25.7.2023, f. 20].



AL

OJ L, 15.5.2024

- (11) Sulmet në rrugët qendrore të transportit detar nga Huthi në Lindjen e Mesme dhe në rajonin e Detit të Kuq janë një shqetësim qendror në lidhje me interesat e Bashkimit dhe të Shteteve Anëtare. Vendimi i Këshillit (CFSP) 2024/632 ⁽²⁾ nisi operacionin e sigurisë detare të Bashkimit Evropian për të mbrojtur lirinë e lundrimit në lidhje me krizën e Detit të Kuq (EUNAVFOR ASPIDES). Është në interesin e Bashkimit dhe të Shteteve Anëtare që të miratojnë masa brenda kornizës së politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë, në mënyrë që të parandalojnë që Houthi-t të kenë akses të mëtejshëm në armët e prodhuara nga Irani, si raketat dhe UAV-të.
- (12) Në funksion të gravitetit të situatës dhe në përgjigje të mbështetjes ushtarake të Iranit për luftën e agresionit të Rusisë kundër Ukrainës, si dhe furnizimin e Iranit me UAV dhe raketa për grupet dhe subjektet e armatosura në Lindjen e Mesme dhe rajonin e Detit të Kuq, e cila minon paqen dhe sigurinë, si dhe sovranitetin e shteteve, është e përshtatshme të futen masa të mëtejshme kufizuese në lidhje me Iranin. Këto masa duhet të mbahen nën shqyrtim dhe duhet të jenë në gjendje të pezullohen ose të tërhiqen, ose të plotësohen me masa të tjera kufizuese, në dritën e zhvillimeve në terren.
- (13) Në veçanti, titulli i Vendimit (CFSP) 2023/1532 duhet të ndryshohet dhe kufizimet e udhëtimit dhe masat e ngrirjes së aseteve duhet të vendosen kundër personave përgjegjës, që mbështesin ose përfshihen në programin e raketave të Iranit, ose furnizojnë, shesin ose përfshihen ndryshe në transferimin e raketave ose UAV-ve të Iranit ose teknologjive të lidhura me Rusinë në mbështetje të luftës së saj të agresionit kundër Ukrainës, ose grupeve të armatosura dhe subjekteve që minojnë paqen dhe sigurinë në Lindjen e Mesme dhe rajonin e Detit të Kuq, ose në kundërshtim me Rezolutën 2216 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (2015).
- (13) Është gjithashtu e përshtatshme të ndalohet eksporti nga Bashkimi në Iran i komponentëve të mëtejshëm që mund të përdoren në zhvillimin dhe prodhimin e UAV-ve.
- (15) Veprime të mëtejshme nga Unioni nevojiten për të zbatuar disa masa.
- (16) Vendimi (CFSP) 2023/1532 duhet të ndryshohet në përputhje me rrethanat,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1

Vendimi (CFSP) 2023/1532 ndryshohet si më poshtë:

(1) titulli zëvendësohet me sa vijon:

“Vendim i Këshillit (CFSP) 2023/1532 i datës 20 korrik 2023 në lidhje me masat kufizuese në funksion të mbështetjes ushtarake të Iranit ndaj luftës së agresionit të Rusisë kundër Ukrainës dhe grupeve dhe subjekteve të armatosura në Lindjen e Mesme dhe rajonin e Detit të Kuq”.

(2) Neni 2 pika 1 zëvendësohet si vijon:

‘1. Shtetet Anëtare do të marrin masat e nevojshme për të parandaluar hyrjen ose kalimin transit nëpër territoret e tyre të personave fizikë:

- (a) përgjegjës për, mbështetjen ose përfshirjen në programin UAV ose raketor të Iranit;
- (b) për furnizimin, shitjen ose përfshirjen ndryshe në transferimin e UAV-ve ose raketave të Iranit ose teknologjive të ngjashme:
- Rusisë në mbështetje të luftës së saj të agresionit kundër Ukrainës;
 - grupeve dhe subjekteve të armatosura që minojnë paqen dhe sigurinë në Lindjen e Mesme dhe në rajonin e Detit të Kuq;
 - personave fizikë ose juridikë, entiteteve ose organeve që veprojnë në kundërshtim me Rezolutën 2216 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (2015); ose
- (c) të lidhur me persona fizikë të përmendur në pikën (a) ose në pikën (b), ose me persona juridikë, entitete ose organe të listuara në përputhje me nenin 3(1);

siç renditen në Aneks.’.

[2] Vendimi i Këshillit (CFSP) 2024/632 i datës 19 shkurt 2024 për nisjen e operacionit të sigurisë detare të Bashkimit Evropian për të mbrojtur lirinë e lundrimit në lidhje me krizën e Detit të Kuq (EUNAVFOR ASPIDES) (OJ L, 2024/632, 20.2.2024, ELI: <http://data.europa.eu/eli/dec/2024/632/oj>).



OJ L, 15.5.2024

AL

(3) Neni 3 pika 1 zëvendësohet si vijon:

'1. Të gjitha fondet dhe burimet ekonomike që i përkasin, ose zotërohen, mbahen ose kontrollohen nga persona, entitete ose organe fizike ose juridike:

(a) përgjegjës për, mbështetjen ose përfshirjen në programin UAV-ve ose raketor të Iranit;

(b) furnizimin, shitjen ose përfshirjen ndryshe në transferimin e UAV-ve ose raketave të Iranit ose teknologjive të ngjashme:

- i. Rusisë në mbështetje të luftës së saj të agresionit kundër Ukrainës;
- ii. grupeve dhe subjekteve të armatosura që minojnë paqen dhe sigurinë në Lindjen e Mesme dhe në rajonin e Detit të Kuq;
- iii. personave fizikë ose juridikë, entiteteve ose organeve që veprojnë në kundërshtim me Rezolutën 2216 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (2015); ose,

(c) të lidhur me persona, entitete ose organe fizike ose juridike të përmendura në pikën (a) ose pikën (b); siç renditet në Aneks, do të ngrihen.'.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi një ditë pas publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Bërë në Bruksel, 14 maj 2024.

Për Këshillin

Presidenti

V. VAN PETEGHEM



2024/1336

15.5.2024

COUNCIL DECISION (CFSP) 2024/1336

of 14 May 2024

amending Decision (CFSP) 2023/1532 concerning restrictive measures in view of Iran's military support to Russia's war of aggression against Ukraine

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union and in particular Article 29 thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

- (1) On 20 July 2023, the Council adopted Decision (CFSP) 2023/1532 ⁽¹⁾.
- (2) In its conclusions of 21 and 22 March 2024, the European Council stated that Russia's access to sensitive items and technologies with battlefield relevance must be restricted to the maximum extent possible, including by targeting entities in third countries enabling the circumvention of sanctions. The European Council called on the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy (the 'High Representative') and the Commission to prepare further sanctions against Belarus, North Korea and Iran. Moreover, the European Council stated that the European Union would continue to work intensely with regional and international partners to prevent further regional escalation, notably in Lebanon and the Red Sea. The European Council called on all actors, notably Iran, to refrain from escalatory actions.
- (3) On 14 April 2024, in the statement by the High Representative on behalf of the Union, the Union condemned in the strongest terms the Iranian drone and missile attacks against Israel on 13 April 2024 as an unprecedented escalation and a threat to regional security.
- (4) In its conclusions of 17 April 2024, the European Council strongly and unequivocally condemned the Iranian attack on Israel and reiterated its full solidarity with the people of Israel and commitment to Israel's security and to regional stability. The European Council called on Iran and its proxies to cease all attacks and urged all parties to exercise the utmost restraint and to refrain from any action that might increase tensions in the region. Furthermore, the European Council conclusions stated that the Union would take further restrictive measures against Iran, notably in relation to unmanned aerial vehicles (UAVs) and missiles. Finally, the European Council reiterated that the Union remains fully committed to contributing to de-escalation and security in the region.
- (5) Russia is using Iranian-produced UAVs in support of its war of aggression against Ukraine, which violates the sovereignty, independence and territorial integrity of that country, including against civilians and civilian infrastructure. The Iranian state-sponsored programme for the development and production of UAVs therefore contributes to violations of the Charter of the United Nations and of fundamental principles of international law.
- (6) The Union is extremely concerned about reports that Iran might transfer missiles to Russia for use in its war of aggression against Ukraine.
- (7) The proliferation of Iranian-produced UAVs and missiles and related technologies to non-state armed groups in the Middle East and beyond is a central issue of concern. Iran has transferred Iranian-produced UAVs and missiles to armed groups and entities, including Hamas, Hezbollah, the Houthis, and militias in Syria and Iraq, as well as to parties to the conflict in Sudan.
- (8) The Iranian missile programme, which is based on state-owned as well as private companies and benefits from domestic research capabilities, is run by the Ministry of Defence and Armed Forces Logistics of Iran and the Islamic Revolutionary Guard Corps, both of which bodies are sanctioned by the Union. The Iranian missile programme includes the procurement, development, production and transfer of missiles.
- (9) Iran maintains a long-standing relationship with armed groups and entities in the Middle East and the Red Sea region, including terrorist organisations such as the military wings of Hezbollah and Hamas, and has provided them with Iranian-produced missiles and means of production.
- (10) Iran's continued provision of arms and related materiel to the Houthis is in violation of United Nations Security Council Resolution 2216 (2015).

⁽¹⁾ Council Decision (CFSP) 2023/1532 of 20 July 2023 concerning restrictive measures in view of Iran's military support to Russia's war of aggression against Ukraine (OJ L 186, 25.7.2023, p. 20).



EN

OJ L, 15.5.2024

- (11) Attacks on central maritime shipping routes by the Houthis in the Middle East and the Red Sea region are a central concern with regard to the interests of the Union and the Member States. Council Decision (CFSP) 2024/632 ⁽²⁾ launched the European Union maritime security operation to safeguard freedom of navigation in relation to the Red Sea crisis (EUNAVFOR ASPIDES). It is in the interest of the Union and the Member States to adopt measures within the framework of the common foreign and security policy in order to prevent the Houthis from gaining further access to Iranian-produced weapons such as missiles and UAVs.
- (12) In view of the gravity of the situation, and in response to Iran's military support to Russia's war of aggression against Ukraine, as well as Iran's supplying of UAVs and missiles to armed groups and entities in the Middle East and the Red Sea region, which undermines peace and security, as well as the sovereignty of states, it is appropriate to introduce further restrictive measures with regard to Iran. Those measures should be kept under review and should be able to be suspended or withdrawn, or be supplemented by other restrictive measures, in light of developments on the ground.
- (13) In particular, the title of Decision (CFSP) 2023/1532 should be amended and travel restrictions and asset freeze measures should be imposed against persons responsible for, supporting or involved in Iran's missile programme, or supplying, selling or otherwise involved in transferring Iran's missiles or UAVs or related technologies to Russia in support of its war of aggression against Ukraine, or to armed groups and entities undermining peace and security in the Middle East and the Red Sea region, or in breach of United Nations Security Council Resolution 2216 (2015).
- (14) It is also appropriate to prohibit the export from the Union to Iran of further components that could be used in the development and production of UAVs.
- (15) Further action by the Union is needed in order to implement certain measures.
- (16) Decision (CFSP) 2023/1532 should therefore be amended accordingly,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

Article 1

Decision (CFSP) 2023/1532 is amended as follows:

- (1) the title is replaced by the following:

'Council Decision (CFSP) 2023/1532 of 20 July 2023 concerning restrictive measures in view of Iran's military support to Russia's war of aggression against Ukraine and to armed groups and entities in the Middle East and the Red Sea region'.

- (2) Article 2(1) is replaced by the following:

'1. Member States shall take the necessary measures to prevent the entry into, or transit through, their territories of natural persons:

- (a) responsible for, supporting or involved in Iran's UAV or missile programme;
- (b) supplying, selling or otherwise involved in transferring Iran's UAVs or missiles or related technologies:
 - (i) to Russia in support of its war of aggression against Ukraine;
 - (ii) to armed groups and entities undermining peace and security in the Middle East and the Red Sea region;
 - (iii) to natural or legal persons, entities or bodies acting in breach of United Nations Security Council Resolution 2216 (2015); or
- (c) associated with natural persons referred to in point (a) or point (b), or with legal persons, entities or bodies listed pursuant to Article 3(1);

as listed in the Annex'.

⁽²⁾ Council Decision (CFSP) 2024/632 of 19 February 2024 launching the European Union maritime security operation to safeguard freedom of navigation in relation to the Red Sea crisis (EUNAVFOR ASPIDES) (OJ L, 2024/632, 20.2.2024, ELI: <http://data.europa.eu/eli/dec/2024/632/oj>).



OJ L, 15.5.2024

EN

(3) Article 3(1) is replaced by the following:

‘1. All funds and economic resources belonging to, or owned, held or controlled by natural or legal persons, entities or bodies:

(a) responsible for, supporting or involved in Iran's UAV or missile programme;

(b) supplying, selling or otherwise involved in transferring Iran's UAVs or missiles or related technologies:

(i) to Russia in support of its war of aggression against Ukraine;

(ii) to armed groups and entities undermining peace and security in the Middle East and the Red Sea region;

(iii) to natural or legal persons, entities or bodies acting in breach of United Nations Security Council Resolution 2216 (2015); or,

(c) associated with natural or legal persons, entities or bodies referred to in point (a) or point (b);

as listed in the Annex, shall be frozen.’.

Article 2

This Decision shall enter into force on the day following that of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

Done at Brussels, 14 May 2024.

For the Council

The President

V. VAN PETEGHEM



VENDIM

Nr. 380, datë 12.6.2024

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SHITESË TË FINANCIMIT TË MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, TË DATËS 28 MARS 2018, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (MARRËSI), PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE DHE EKONOMISË, DHE KfW, FRANKFURT AM MAIN (KfW), PËR PROJEKTIN “FONDI PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL (AFP) DHE PUNËSIMIN: QENDRA SHUMËFUNKSIONALE NË KAMZË”, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 330, DATË 6.6.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes shtesë të financimit të marrëveshjes së financimit, të datës 28 mars 2018, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (marrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW, Frankfurt am Main (KfW), për projektin “Fondi për arsimin dhe formimin profesional (AFP) dhe punësimin: Qendra shumëfunksionale në Kamzë”, miratuar me vendimin nr. 330, datë 6.6.2018, të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MARRËVESHJE SHITESË FINANCIMI

E DATËS 8 MARS 2024

E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT TË DATËS 28 MARS 2018 (“MARRËVESHJE ORIGINALE FINANCIMI”) NDËRMJET KfW, FRANKFURT AM MAIN (“KfW”) DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (“PËRFITUESI”) TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE PËR SHUMËN 2,000,000.00 EURO

- Fondi për Arsimin dhe Aftësimin Profesional (AAP) dhe Punësimin:
Qendra Multifunksionale e Kamzës
BMZ - nr. 2016 67 500

PËRMBAJTJA

Seksioni 1 – Termat

Seksioni 2 – Ndryshimet e Marrëveshjes Originale të Financimit

Seksioni 3 – Dispozitat shtesë

Seksioni 4 – Përfshirja e termave

Seksioni 5 – Hyrja në fuqi

Zotimet e pajtueshmërisë

Në bazë të Marrëveshjes së lidhur ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunimin Financiar 2016, për Projektin “Fondi për arsimin dhe aftësimin profesional dhe për punësimin” (“**Marrëveshja qeveritare**”), Përfituesi dhe KfW-ja bien dakord të lidhin Marrëveshjen e mëposhtme të financimit:

Seksioni 1 – Termat

Në bazë të dispozitave shprehimisht kundër në këtë Marrëveshje Shtesë Financimi ose përveç rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e përcaktuar në Marrëveshjen Originale të Financimit do të kenë të njëjtën kuptim si në këtë Marrëveshje.

Seksioni 2 – Ndryshimet e Marrëveshjes Originale të Financimit

2.1. Dispozitat e mëposhtme të Marrëveshjes Originale të Financimit ndryshohen si më poshtë:

a) Fjalja e parë e nenit 1.1 fshihet dhe zëvendësohet me sa më poshtë:

“KfW-ja do t'i ofrojë Përfituesit një kontribut financiar që nuk tejkalon shumën 6,500,000,00 euro (me fjalë: gjashtë milionë e pesëqind mijë euro).

b) Neni 2.2 fshihet dhe zëvendësohet me sa më poshtë:



“KfW-ja ka të drejtë të refuzojë të kryejë disburseime pas datës 31 dhjetor 2025.”

c) Neni 6.1(c) fshihet dhe zëvendësohet me sa më poshtë:

“në çdo kohë është në përputhje me dispozitat e prokurimit të përcaktuara në marrëveshjen e veçantë, duke përfshirë planin përkatës të prokurimit.”

d) Fjalja e parë e nenit 7.1 (*Publikimi dhe transferimi i informacionit të lidhur me Projektin*) fshihet dhe zëvendësohet me sa më poshtë:

“Për të përmbushur parimet e pranuar ndërkombëtarisht për arritjen e transparencës dhe efikasitetit maksimal në bashkëpunimin për zhvillim, KfW-ja publikon informacionin e përzgjedhur (përfshirë rezultatet e vlerësimit dhe të kategorizimit mjedisor dhe social, si dhe raporte të vlerësimit të mëposhtëm (*ex post*)) rreth Projektit dhe financimit të tij gjatë negociatave parakontraktuale, paralelisht me zbatimin e marrëveshjes/ve të lidhur/a me Projektin dhe në fazën paskontraktuale (në vijim e referuar si “**Periudha e Plotë**”).”

f) Nenet 8.1 dhe 8.2 (*Dispozita të ndryshme*) fshihen dhe zëvendësohen me sa më poshtë, të cilat bëhen neni i ri 8.1 (dhe neni 8.2 lihet i paplotësuar):

“Përfituesi merr përsipër të përmbushë në çdo kohë detyrimet e përcaktuara në shtojcë (Zotimet e Pajtuësshmërisë).”

2.2. Shtojca Zotimet e Pajtuësshmërisë bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje Shtesë Financimi bashkëlidhet si një shtojcë e re dhe bëhet një pjesë integrale e Marrëveshjes Origjinale të Financimit.

2.3. Të gjitha dispozitat e tjera të Marrëveshjes Origjinale të Financimit mbeten të pandryshuara.

Seksioni 3 – Dispozitat shtesë

Me anë të shmangies së nenit 18.6 të Marrëveshjes Origjinale të Financimit, marrëdhëniet ligjore të krijuara nga Marrëveshja Origjinale e Financimit dhe kjo Marrëveshje Shtesë Financimi ndërmjet KfW-së dhe Përfituesit përfundojnë në fund të kohëzgjatjes së frytshme të Projektit, por jo më vonë se 15 vjet pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje Shtesë Financimi.

Seksioni 4 – Përfshirja e termave

Dispozitat e nenit 4 (*Kostot dhe tarifatat publike*), neni 5 (*Deklaratat kontraktuale dhe tagri i përfaqësimit*) dhe neneve 8.3, 8.4 dhe 8.5 (*Dispozita të ndryshme*) të Marrëveshjes Origjinale të Financimit përfshihen në këtë Marrëveshje Shtesë Financimi, siç përcaktohet plotësisht në këtë Marrëveshje Shtesë Financimi dhe

sikur referencat në ato klauzola për “Marrëveshjen” ose “këtë Marrëveshje” janë referenca të kësaj Marrëveshjeje Shtesë Financimi.

Seksioni 5 – Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje Shtesë Financimi hyn në fuqi kur Përfituesi ka informuar me shkrim KfW-në, se procedurat e brendshme ligjore për t’u përmbushur nga Përfituesi janë përfunduar (data e marrjes nga KfW-ja).

Bërë në 2 (dy) origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main, 27.3.2024

KfW

Nënshkrimi

Emri: Hille Henebry

Pozicioni: Përgjegjës

i Divizionit

Tiranë, 8.3.2024

Nënshkrimi

Emri:

Pozicioni: Menaxher

i Lartë i Portofolit

Republika e Shqipërisë,

e përfaqësuar nga Ministria e Financave

Nënshkrimi

Emri: Ervin Mete

Pozicioni: Ministria e Financave

Shtojca

Zotimet e pajtuësshmërisë

Shtojcë

ZOTIMET E PAJTUESHMËRISË

1. PËRKUFIZIME

“**Praktikë shtrënguese**”, dëmtimi apo lëndimi ose kërcënim për të dëmtuar apo lënduar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një person apo pronë të ndonjë personi për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme mbi veprimet e një personi;

“**Praktikë e fshehtë**”, është një marrëveshje midis dy apo më shumë personave, me qëllim arritjen e një synimi të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e papërshtatshëm në veprimet e një personi tjetër;

“**Praktikë korruptive**”, premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, insistimi për të dhënë, marrja, pranimi ose kërkimi, qoftë drejtpërdrejt ose tërthorazi, i ndonjë pagese të jashtëligjshme ose avantazhi të papërshtatshëm të çfarëdolloj natyre, për apo nga çdo person, me qëllim ndikimin në veprimet e një personi apo pengimin e atij personi për të vepruar.



“Praktikë mashtruese”, nënkupton çdo veprim ose mosveprim, duke përfshirë një keqpërfaqësim që çorienton ose synon të çorientojë, qoftë me ose pa dashje, një person me qëllim marrjen e një përfitimi financiar ose shmangien e një detyrimi;

“Praktikë penguese”: i shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja e qëllimshme e provave materiale hetimore ose dhënia e dëshmime të rreme për hetuesit, për të penguar materialisht një hetim zyrtar mbi dyshimet e një praktike korruptive, praktike mashtruese, praktike shtrënguese, praktike të fshehtë ose kërcënimi, ngacmimi apo frikësimi të një personi, për të mos e lejuar atë që të tregojë gjithçka për çështje që lidhen me hetimin, ose nga kryerja e hetimit; ose ii. çdo akt që synon të pengojë materialisht ushtrimin e aksesit të KfW-së në informacionin e kërkuar kontraktualisht lidhur me një hetim zyrtar mbi dyshimet e një Praktike Korruptive, Praktike Mashtruese, Praktike Shtrënguese ose Praktike të Fshehtë.

“Person”, një person fizik, person juridik, partneritet apo shoqatë e pathemeluar në formën e korporatës.

Praktikë e sanksionueshme: çdo praktikë shtrënguese, praktikë e fshehtë, praktikë korruptive, praktike mashtruese, ose praktikë penguese (sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje), që: i. është e paligjshme sipas legjislacionit gjerman ose ligjeve të tjera të zbatueshme; dhe që ii. ka ose mund të ketë efekt material ligjor ose reputacional mbi këtë Marrëveshje ndërmjet Përfituesit dhe KfW-së apo zbatimin e saj.

“Organ Sanksionues”, Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe Republika Federale e Gjermanisë.

“Sanksione”, sanksionet, ligjet, rregulloret, embargot apo masat shtrënguese ekonomike, financiare ose tregtare, të administruara, miratuara apo zbatuara nga organi sanksionues.

“Listë e sanksioneve”, çdo listë e personave, grupeve apo subjekteve të përcaktuara në mënyrë specifike që u nënshtrohen sanksioneve, e lëshuar nga ndonjë organ sanksionues.

2. SIPËRMARRJA LIDHUR ME INFORMACIONIN

Përfituesi:

a) i vë në dispozicion KfW-së menjëherë, sipas kërkesës së kësaj të fundit, të gjithë informacionin përkatës që lidhet me “njohjen e klientit” apo

informacione të ngjashme për Përfituesin që KfW-ja mund të kërkojë;

b) i ofron KfW-së menjëherë, sipas kërkesës, të gjithë informacionin dhe dokumentet e lidhura me Projektin, të Përfituesit dhe palëve të tij (nën)kontraktuese dhe palëve të tjera përkatëse, te të cilat KfW-ja bazohet për të përmbushur detyrimet e saj për parandalimin e praktikave të sanksionueshme, pastrimin e parave, ose financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit me Përfituesin që është e nevojshme për këtë qëllim;

c) informon KfW-në menjëherë dhe me pëlqimin e tij, sapo merr dijeni apo dyshon për ndonjë praktikë të sanksionueshme, akt pastrimi parash dhe/ose financim terrorizmi të lidhur me Projektin;

d) i jep KfW-së çdo dhe të gjitha informacionet dhe raportet mbi Projektin dhe ecurinë e tyre të mëtejshme, siç KfW-ja mund të kërkojë, për qëllimet e kësaj Shtojce; dhe

e) i mundëson KfW-së dhe agjentëve të saj, në çdo kohë, inspektimin e të gjithë dokumentacionit tjetër të Përfituesit dhe palëve të tij (nën)kontraktuese apo palëve të tjera të lidhura me të mbi Projektin dhe kryerjen e vizitave në Projekt dhe në të gjitha instalimet përkatëse, për qëllimet e kësaj shtojce.

3. PËRFAQËSIMI DHE GARANCIA

3.1. Për sa i përket legjislacionit gjerman apo legjislacionit të vendit të Përfituesit, ky i fundit shprehet se asnjë prej personave që vepron në emër të Përfituesit për projektin, nuk ka kryer ose nuk është angazhuar në praktikë të sanksionueshme, pastrim parash apo financim terrorizmi.

3.2. Përfaqësimi dhe garancia e përcaktuar në këtë nen jepen për herë të parë, duke përfshirë këtë shtojcë në këtë Marrëveshjeje. Ajo do të konsiderohet e përsëritur me çdo tërheqje të kontributit financiar, duke iu referuar rrethanave mbizotëruese në atë datë.

4. SIPËRMARRJET POZITIVE

Përfituesi ndërmerr të bashkëpunojë plotësisht me KfW-në dhe agjentët e tij sapo Përfituesi apo KfW-ja të marrë dijeni apo të dyshojë për ndonjë praktikë të sanksionueshme, akt pastrimi parash apo financim terrorizmi, për të përcaktuar nëse ka ndodhur ky incident përputhshmërie. Në veçanti, Përfituesi i përgjigjet menjëherë dhe në detaje të arsyeshme çdo njoftimi të KfW-së dhe ofron



mbështetje dokumentuese për këtë përgjigje, me kërkesë të KfW-së.

5. SIPËRMARRJET NEGATIVE

Përfituesi nuk lidh transaksione apo nuk angazhohet në veprimtari të tjera lidhur me Projektin, të cilat përbëjnë shkelje të sanksioneve.

VENDIM

Nr. 381, datë 12.6.2024

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E MIRATUAR PËR VITIN 2024, NDËRMJET PROGRAMEVE TË MINISTRISË SË DREJTËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe të ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Aparatit të Ministrisë së Drejtësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2024, në programin buxhetor 01110 “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, i shtohet fondi prej 17 500 000 (shtatëmbëdhjetë milionë e pesëqind mijë) lekësh, në zërin “Shpenzime korrente”.

2. Fondi prej 17 500 000 (shtatëmbëdhjetë milionë e pesëqind mijë) lekësh, që shtohet në zërin “Shpenzime korrente”, nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Drejtësisë, për vitin 2024, do të pakësohet, përkatësisht, në masën:

a) 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë, nga programi buxhetor 03310 “Ndihma juridike” në zërin “Shpenzime korrente”;

b) 5 500 000 (pesë milionë e pesëqind mijë) lekë, nga programi buxhetor 01120 “Publikimet zyrtare” në zërin “Shpenzime korrente”;

c) 2 000 000 (dy milionë) lekë, nga programi buxhetor 03350 “Shërbimi i përmbarimit gjyqësor” në zërin “Shpenzime korrente”.

3. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

VENDIM

Nr. 382, datë 12.6.2024

PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT TË PARË, PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES, PËR KUSHTET PËR AKSES TË LIRË NË TREGUN E PUNËS NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm dhe të ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e protokollit të parë, për zbatimin marrëveshjes, për kushtet për akses të lirë në tregun e punës në Ballkanin Perëndimor, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

PROTOKOLL I PARË MBI ZBATIMIN E MARRËVESHJES PËR KUSHTET PËR AKSES TË LIRË NË TREGUN E PUNËS NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Ne, pjesëmarrësit e Ballkanit Perëndimor, të referuar bashkërisht si “Palët kontraktuese” dhe individualisht si “Pala kontraktuese”;

në përputhje me nenin 16 të marrëveshjes për kushtet për akses të lirë në tregun e punës në Ballkanin Perëndimor, të nënshkruar më 21 dhjetor 2021, në Tiranë (në vijim e referuar si “Marrëveshja”),

kanë rënë dakord, si më poshtë:

Neni 1

Ky protokoll përcakton kushtet për zbatimin e marrëveshjes për kushtet për akses të lirë në tregun e punës në Ballkanin Perëndimor, veçanërisht për caktimin e kritereve të përbashkëta për regjistrimin e shtetasve të palëve kontraktuese, si dhe çështjet që



lidhen me punën dhe vendbanimin e shtetasve të palëve kontraktuese në territorin e palës marrëse.

Termat dhe shprehjet e përdorura në këtë protokoll do të kuptohen siç përcaktohen në marrëveshje.

Neni 2

Shtetasi i një pale kontraktuese (në vijim i referuar si: aplikanti), në përputhje me nenin 7 të marrëveshjes, do të përdorë shërbimin elektronik online, të krijuar për akses falas në tregun e punës në portalin e qeverisjes elektronike të palës marrëse.

Të dhënat për identitetin elektronik të konfirmuar të personit që aplikon për shërbimin sipas paragrafit 1 të këtij neni, jepen në përputhje me marrëveshjen për ndërlidhjen e skemave për identifikimin elektronik të shtetasve të Ballkanit Perëndimor.

Aplikanti duhet t'i dorëzojë palës marrëse si të dhënat e tij/saj personale edhe të dhënat e tjera, në lidhje me rrethanat e punës dhe qëndrimit të tij/saj marrëse.

Të dhënat personale të përmendura në paragrafin 3 të këtij neni, përfshijnë:

1. Numrin e identifikimit (ID) të Ballkanit të Hapur;
2. Emrin dhe mbiemrin;
3. Datën e lindjes;
4. Shtetin e lindjes;
5. Numrin unik të identifikimit vendas të dhënë nga pala kontraktuese, ku ai/ajo është shtetas;
6. Gjininë;
7. Shtetësinë.

Të dhënat e tjera, të përmendura në paragrafin 3 të këtij neni, përfshijnë:

1. Llojin e dokumentit, numrin dhe datën e skadimit (kartë identiteti e vlefshme ose dokument biometrik udhëtimi) dhe kopjen bashkëlidhur të dokumentit;
2. Emrin dhe mbiemrin e babait;
3. Emrin dhe mbiemrin e nënës;
4. Mbiemrin e vajzërisë - nëse është e zbatueshme;
5. Adresën e *email*-it;
6. Numrin e telefonit celular;
7. Adresën ku aplikanti ose banon, ose synon të banojë në palën marrëse;
8. Lejet e mëparshme të qëndrimit të dhëna në palën marrëse;

9. Gjendjen civile;

10. Vetëdeklarimin e statusit gjyqësor në palën kontraktuese, shtetas i së cilës ai ose ajo është;

11. Vetëdeklarimin se nuk përbën rrezik për shëndetin publik;

12. Vetëdeklarimin lidhur me fëmijët e mitur dhe/ose bashkëshortin dhe synimin për bashkim familjar;

13. Vetëdeklarimin mbi burimet financiare për banim në palën marrëse;

14. Vetëdeklarimin lidhur me të dhënat për automjetin e regjistruar jashtë palës marrëse, të cilat ai/ajo synon t'i përdorë në palën marrëse;

15. Foton e fundit, jo më të vjetër se 6 muaj;

16. Informacion rreth punësimit të mundshëm;

17. Informacion për arsimin dhe kualifikimet profesionale.

Pjesë përbërëse e formularit të aplikimit në internet është deklarata e aplikantit se ai/ajo po e dorëzon formularin personalisht, se të gjitha të dhënat e ofruara janë të vërteta dhe se ai/ajo është në dijeni të pasojave të dhënies së informacionit të rremë ose fshehjes së informacionit.

Neni 3

Pala marrëse, në përputhje me legjislacionin e brendshëm, shqyrton nëse kushtet e përcaktuara në nenin 4 të marrëveshjes janë përmbushur, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së aplikimit, nëpërmjet shërbimit elektronik online të përmendur në paragrafin 1 të nenit 2.

Pas përfundimit të procedurës së përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, aplikanti merr njoftim elektronik.

Neni 4

Nëse akses i lirë në tregun e punës është miratuar, aplikanti do të marrë miratimin elektronik për akses të lirë në tregun e punës.

Miratimi për akses të lirë në tregun e punës, i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, përfshin:

1. Numrin e identifikimit (ID) të Ballkanit të Hapur;
2. Numrin e aplikimit/miratimit për akses të lirë në tregun e punës;
3. Emrin dhe mbiemrin;
4. Datën e lindjes;
5. Gjininë;



6. Numrin unik të identifikimit vendas;
7. Shtetësinë;
8. Numrin e telefonit celular;
9. Adresën e *email*-it;

10. Llojin e dokumentit, numrin dhe datën e skadimit (kartë identiteti e vlefshme ose dokument biometrik udhëtimi);

11. Periudhën e vlefshmërisë së miratimit për akses të lirë në tregun e punës;

12. Numrin unik ID të shtetasit të huaj, të caktuar nga pala marrëse për aplikantin;

13. Kodin QR që përmban të dhëna që mundëson kontrollin elektronik të vlefshmërisë së miratimit dhe të dhënave të aplikantit;

Miratimi për akses të lirë në tregun e punës është dokument i vulosur elektronikisht, i lëshuar nga autoritetet e mëposhtme të palëve kontraktuese:

1. Republika e Serbisë – Shërbimi Kombëtar i Punësimit, i vulosur elektronikisht nga Zyra për Teknologjitë e Informacionit dhe Qeverisjen Elektronike;

2. Republika e Shqipërisë – Drejtoria Rajonale për Kufirin dhe Migracionin, Policia e Shtetit Shqiptar;

3. Republika e Maqedonisë së Veriut – Ministria e Shoqërisë së Informacionit dhe Administratës.

Paraqitja dhe përmbajtja e miratimit për akses të lirë në tregun e punës bashkëlidhet këtu dhe është pjesë përbërëse e këtij protokoli (shtojca 1).

Bazuar në dispozitat e nenit 15 të marrëveshjes, secila palë kontraktuese rezervon të drejtën t'i lëshojë dokumente shtesë shtetasit të palës kontraktuese, të cilit i është dhënë akses falas në tregun e punës me kërkesën e tij, në përputhje me legjislacionin e brendshëm.

Neni 5

Nëse akses i lirë në tregun e punës nuk është miratuar, aplikanti do të njoftohet në mënyrë elektronike se akses i lirë në tregun e punës refuzohet.

Aplikanti mund të riaplikojë brenda 30 ditëve nga dërgimi i njoftimit për refuzimin e aksesit të lirë në tregun e punës.

Neni 6

Nëse të dhënat e përmendura në nenin 2 të këtij protokoli ndryshojnë, një shtetas i një pale

kontraktuese, të cilit i është lëshuar miratimi për akses të lirë në tregun e punës, duhet pa vonesë dhe jo më vonë se 5 ditë pune, nëpërmjet shërbimit elektronik të palës marrëse, të hyjë në aplikimin e tij/të saj të mëparshëm të regjistrimit dhe të përditësojë të dhënat.

Pas përditësimit të të dhënave, ai/ajo do të njoftohet elektronikisht se ndryshimet janë prezantuar me sukses dhe do të marrë miratimin e përditësuar për akses të lirë në tregun e punës.

Nëse ka një ndryshim në të dhënat që lidhen me zbatimin e marrëveshjes (d.m.th. ndryshim të shtetësisë), miratimi për akses të lirë në tregun e punës pushon së qenuri i vlefshëm.

Neni 7

Nëse një shtetas i një pale kontraktuese i është dhënë më parë qëndrimi i përkohshëm në palën marrëse për qëllime të ndryshme nga ato të parashikuara në marrëveshje dhe ai/ajo regjistrohet për akses të lirë në tregun e punës, aplikimi do të miratohet nëse kushtet e përcaktuara nga marrëveshja plotësohen dhe pala marrëse revokon qëndrimin e përkohshëm të dhënë më parë.

Nëse një shtetas i një pale kontraktuese i është dhënë më parë akses i lirë në tregun e punës në palën marrëse në bazë të marrëveshjes dhe më pas i jepet qëndrim i përkohshëm në palën marrëse me kërkesën e tij/saj, në përputhje me legjislacionin vendas, miratimi për akses të lirë në tregun e punës pushon së qenuri i vlefshëm.

Neni 8

Një shtetas i një pale kontraktuese mund të iniciojë reregjistrimin e përmendur në nenin 7, paragrafi 4 i marrëveshjes, brenda 60 ditëve përpara datës së skadimit të miratimit për akses të lirë në tregun e punës.

Reregjistrimi do të kryhet në të njëjtën mënyrë si regjistrimi i parë, në përputhje me nenin 7 të marrëveshjes dhe me këtë protokoll.

Neni 9

Palët kontraktuese do të ofrojnë shërbimin, lidhur me procesin e aplikimit për akses të lirë në tregun e punës, në gjuhën maqedonase, shqipe dhe serbe.



Neni 10

Palët kontraktuese do të krijojnë grupin e përbashkët të punës për të diskutuar dhe zgjidhur të gjitha pengesat ligjore dhe teknike që lindin nga zbatimi i marrëveshjes dhe i këtij protokoll.

Palët kontraktuese do të caktojnë secila një person me detyrën për të drejtuar dhe bashkëkryesuar takimet e grupit të përbashkët të punës dhe për të përfaqësuar pikën kryesore të kontaktit për koordinimin dhe zbatimin e këtij protokoll.

Palët kontraktuese mund të caktojnë aq njerëz sa është e nevojshme si anëtarë të grupit të përbashkët të punës për të përmbushur detyrimet e fushave të bashkëpunimit të përcaktuara në marrëveshje dhe në këtë protokoll.

Palët kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve të duhura, për personat e caktuar të përmendur në paragrafin 2 të këtij neni dhe do shkëmbejnë informacion mbi pikat e kontaktit, jo më vonë se 7 ditë nga data e nënshkrimit të këtij protokoll.

Neni 11

Për secilën palë kontraktuese, ky protokoll do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit

me shkrim, me të cilën palët njoftojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet depozituesit, për përfundimin e procedurave, sipas legjislacionit të tyre të brendshëm për hyrjen në fuqi të këtij protokoll.

Palët mund ta ndryshojnë këtë protokoll me shkrim.

Ky protokoll është lidhur për një periudhë kohore të pacaktuar dhe do të mbetet në fuqi për sa kohë që marrëveshja mbetet në fuqi.

Origjinali i këtij protokoll do të depozitohet pranë qeverisë së Republikës së Shqipërisë, në një kopje të vetme në gjuhën angleze, si depozitare e marrëveshjes, e cila do t'i transmetojë një kopje të certifikuar secilës palë kontraktuese.

Bërë në Shkup, më 22 janar dy mijë e njëzet e katër.

NË EMËR TË QEVERISË SË MAQEDONISË SË
VERIUT
Vedat Osmani

NË EMËR TË QEVERISË SË SHQIPËRISË
Adela Xhemaili

NË EMËR TË QEVERISË SË SERBISË
Gojko Stanivukovic



Shtojcë 1

SKICA DHE PËRMBAJTJA E LEJES UNIKE – MIRATIMI PËR AKSES TË LIRË NË TREGUN
E PUNËS (MADHËSIA A4)

 ОДБОРЕЊЕ ЗА СЛОБОДАН ПРИСТУП ТРЖИШТУ РАДА		Број Одобрења / Approval number / Numri i aprovimit / Брз на одобрување	
Approval for free access to labour market		Апрорим пѐр аксес тѐ трѐ нѐ трѐгун е пунѐс	
Одобрување за слободан приста до пазар на труд			
Презиме / Сопреиме / Имени / Презиме / Име / Name / Emri / Име		Идентификациони број Отвореног Балкан / Open Ba kan ID number / Numri i ID пѐр Bal kanin e Hapir / Идентификациски број Отвореног Балкан	
Датум рођења / Date of birth / Ditëlindja / Дата на раѓање			
Пол / Gender / Gënj / Пол			
Јединствени матични број граѓана / Unique domestic personal ID number / Numri unik personal i identitetit (i shtetëtar) / Единствени матични број на граѓанинот			
Држављанство / Citizenship / Shtetësi / Државјанство			
Број мобилног телефона / Mobile phone number / Numri mobil / Број на мобилен телефон			
Е-пошта адреса / E-mail address / Adresë e mail / Адреса на електронска пошта			
Број документа / Doqumenti / Број документа / Broj dokumenti / Број документа / Broj dokumenti / Број документа / Broj dokumenti			
Уникатен европски број странца / Unique foreigner ID number / Numri unik i ID пѐr të huajin / Истичен матичен број за странец		Период важења слободаног приступа тржишту рада / Validity period of the approval for free access to labor market / Periudha e vlefshmërisë së aprovimit për akses të lirë në tregun e punës / Период на важење за слободан пристап до пазарот на труд	
Електронски документ / Electronic document / Dokument elektronik / Вулѐ електроникѐ / Dokumenti elektronik			
Потврда се издава како електронски документ и одштапан / Approval is issued as electronic document and printed version represents a copy of the document / Approvimi është vlefshëm me dokument personal përkaqse qe vetëdijetori është një person i Poterdhata e vlefshme samsë lo soshdeten личен документ со кој се докажува идентитетот			



VENDIM
Nr. 383, datë 12.6.2024

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
MË TË DETAJUARA PËR MËNYRËN E
ORGANIZIMIT DHE TË
FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TË
OBJEKTEVE TË KONFISKUARA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 11, të ligjit nr. 66/2023, “Për administrimin e objekteve të konfiskuara si ndërtime pa leje, me qëllim përdorimin e tyre për interes publik apo strehim social, si dhe zbutjen e pasojave sociale të shkaktuara”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky vendim përcakton rregullat e detajuara për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Komisionit të Objekteve të Konfiskuara (në vijim “Komisioni”).

KREU II
ORGANIZIMI I KOMISIONIT

Neni 2
Organizimi i Komisionit

1. Komisioni është organ kolegjal, i cili krijohet pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe në ushtrimin e veprimtarisë së tij mbështetet nga struktura përgjegjëse për pronat e paluajtshme në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, si sekretariat teknik (në vijim “Sekretariati”).

2. Komisioni përbëhet nga 9 (nëntë) anëtarë, sipas parashikimeve në pikën 2, të nenit 11, të ligjit nr. 66/2023, “Për administrimin e objekteve të konfiskuara si ndërtime pa leje, me qëllim përdorimin e tyre për interes publik apo strehim social, si dhe zbutjen e pasojave sociale të shkaktuara”.

3. Anëtarët e Komisionit, parashikuar në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d” dhe “dh”, të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 66/2023, “Për administrimin e objekteve të konfiskuara si ndërtime pa leje, me qëllim përdorimin e tyre për interes publik apo strehim social, si dhe zbutjen e pasojave sociale të shkaktuara”, caktohen nga titullari i institucionit, bazuar në kriteret e mëposhtme:

- a) të jetë drejtues i nivelit të lartë politik;
- b) të jetë nëpunës/punonjës i nivelit të lartë drejtues;
- c) të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- ç) të ketë njohuri në fushën ekonomike, juridike, inxhinierike.

Përjashtohen nga kriteret e përcaktuara në shkronjat “c” dhe “ç” anëtarët e komisionit, që i përkasin nivelit të lartë politik.

4. Mandati i anëtarit të Komisionit është 3 (tre) vjet, me të drejtë riemërimi. Anëtari qëndron në detyrë dhe përmbush funksionet deri në emërimin e anëtarit të ri, përveç rasteve të parashikuara në shkronjat “b” deri në “e”, të pikës 5, të nenit 2, të këtij vendimi.

5. Mandati i anëtarit të Komisionit mbaron, kur:

- a) përfundon afati 3-vjeçar nga emërimi;
- b) lirohet nga funksioni zyrtar;
- c) jep dorëheqjen;
- ç) ndodhet në kushtet e konfliktit të vazhdueshëm të interesit;
- d) për shkaqe objektive që e bëjnë të paafte për të kryer funksionet e ngarkuara;
- dh) nuk merr pjesë në 3 (tri) mbledhje të njëpasnjëshme, pa një shkak të ligjshëm;
- e) dënohet me vendim penal të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

Neni 3
Zgjedhja e kryetarit dhe detyrat

1. Ministri përgjegjës i pronës shtetërore cakton si kryetar të Komisionit një nga dy përfaqësuesit e ministrisë përgjegjëse për pronën shtetërore.

2. Kryetari i Komisionit ushtron këto funksione:

- a) thërret dhe drejton mbledhjet e Komisionit;
- b) përfaqëson Komisionin në marrëdhëniet me të tretët, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi;
- c) nënshkruan vendimet e Komisionit;
- ç) ushtron çdo funksion tjetër, të përcaktuar sipas ligjit nr. 66/2023, “Për administrimin e objekteve të konfiskuara si ndërtime pa leje, me qëllim përdorimin e tyre për interes publik apo strehim social, si dhe zbutjen e pasojave sociale të shkaktuara”.



rimin e tyre për interes publik apo strehim social, si dhe zbutjen e pasojave sociale të shkaktuara”.

Në rast mungese, kryetari zëvendësohet nga zëvendëskryetari, i cili zgjidhet nga Komisioni në mbledhjen e tij të parë të çdo viti kalendarik, me rotacion midis anëtarëve.

Neni 4

Sekretariati i Komisionit

1. Sekretariati i Komisionit është pjesë përbërëse e strukturës administrative të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në funksion të Komisionit, i cili përgatit dhe administron dokumentacionin për vendimmarrje të Komisionit.

2. Sekretariati i Komisionit ka këto detyra:

a) njofton anëtarët e Komisionit për datën, orën, mënyrën, rendin e ditës dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes, të paktën 5 (pesë) ditë para datës që caktohet për zhvillimin e saj;

b) organizon mbledhjet e Komisionit;

c) përgatit dokumentacionin e mbledhjes së Komisionit dhe ua dërgon materialet e mbledhjes anëtarëve të Komisionit, sipas rendit të ditës së mbledhjes së miratuar nga kryetari, të paktën 3 (tri) ditë para datës së mbledhjes;

ç) mban procesverbal për çdo mbledhje, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit;

d) verifikon kuorumin e nevojshëm për mbajtjen e mbledhjes së Komisionit;

dh) administron protokollin dhe vulën e Komisionit, në përputhje me ligjin për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjen e vulave zyrtare;

e) zbardh vendimet e marra në mbledhjen e Komisionit, brenda 2 (dy) ditëve nga mbajtja e mbledhjes;

ë) administron dokumentacionin dhe e përcjell atë për arkivim pranë strukturës përkatëse, në përputhje me legjislacionin për arkivat;

f) pas autorizimit të kryetarit të Komisionit, u vë në dispozicion informacion palëve të treta, në përputhje me ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”.

Neni 5

Bashkëpunimi me institucionet

1. Ministria përgjegjëse për administrimin e pronës shtetërore, Agjencia e Zhvillimit të Territorit,

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Enti Kombëtar i Banesave, autoriteti/et publik/e në cilësinë e njësisë së zbatimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe çdo institucion tjetër, që konsiderohet i nevojshëm, kanë detyrimin për të bashkëpunuar me Komisionin, si dhe për të vendosur në dispozicion çdo informacion apo dokumentacion të nevojshëm, me qëllim mirëfunksionimin dhe vendimmarrjen e drejtë të Komisionit.

2. Vendimet e marra nga Komisioni janë të detyrueshme për t’u zbatuar.

KREU III

Neni 6

Detyrimi i pjesëmarrjes në mbledhje dhe procedura në rast të pengesës ligjore dhe konfliktit të interesit

1. Komisioni mbledhet sa herë është i nevojshëm shqyrtimi i një çështjeje ose rasti, por jo më pak se 6 (gjashtë) herë në vit.

2. Kryetari thërret mbledhjen dhe vendos për rendin e ditës, datën, orën, vendin dhe mënyrën e zhvillimit të saj. Mbledhjet mbahen pranë ambienteve të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Për shkak të natyrës së veçantë të punës dhe vendimmarrjes së Komisionit, anëtarët duhet të jenë të pranishëm fizikisht në mbledhje, përjashtuar rastet e jashtëzakonshme, ku anëtarët mund të marrin pjesë në mbledhje nëpërmjet mjeteve të komunikimit audio dhe video në distancë, të cilat garantojnë identitetin e anëtarit.

3. Mbledhja mund të kërkohet me shkrim edhe nga 1/3 e anëtarëve të Komisionit. Kryetari është i detyruar të thërrasë mbledhjen e Komisionit në datën, orën, vendin, mënyrën, duke përfshirë në rendin e ditës çështjet e kërkuara nga 1/3 e anëtarëve të Komisionit.

4. Në pamundësi objektive, papajtueshmëri, konflikt interesi ose pengesë ligjore të kryetarit, veprimet përgatitore dhe thirrja e mbledhjes kryhen nga zëvendëskryetari.

5. Pjesëmarrja e anëtarëve të Komisionit në mbledhjet dhe veprimtaritë e tij është e detyrueshme përgjatë gjithë periudhës së ushtrimit të kësaj detyre.

6. Në rastin kur në lidhje me çështje të caktuara, që trajtohen në veprimtarinë dhe mbledhjet e Komisionit, anëtari i Komisionit vihet në dijeni të



rrethanave të tilla, që sipas ligjit, e vendosin atë përpara njërit prej rasteve të konfliktit të interesit ose të pengesës ligjore, njofton menjëherë kryetarin e Komisionit dhe deklarën arsyet konkrete që sjellin pengesë për pjesëmarrjen në përgatitjen, diskutimin dhe miratimin e çështjes përkatëse.

7. Në rastet kur një anëtar nuk merr pjesë në 3 (tri) mbledhje të njëpasnjëshme, pa një shkak të ligjshëm, zëvendësohet me një anëtar tjetër nga institucioni i cili ka propozuar anëtarin, sipas përbërjes së përcaktuar në pikën 2, të nenit 11, të ligjit nr. 66/2023, “Për administrimin e objekteve të konfiskuara si ndërtime pa leje, me qëllim përdorimin e tyre për interes publik apo strehim social, si dhe zbutjen e pasojave sociale të shkaktuara”.

Neni 7

Kuorumi i mbledhjes së Komisionit

1. Mbledhja e Komisionit është e vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij.

2. Vendimet e Komisionit merren me votim të hapur dhe komisioni vendos me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

3. Kur nuk sigurohet kuorumi i nevojshëm, kryetari vendos thirrjen e mbledhjes pasardhëse, të paktën 24 (njëzet e katër) orë pas së parës. Në këtë rast, mbledhja është e vlefshme në qoftë se janë të pranishëm së paku gjysma e anëtarëve me të drejtë vote.

Neni 8

Mënyra e procedura e votimit dhe procesverbal i mbledhjes

1. Anëtarët, që janë të pranishëm në mbledhje dhe që nuk kanë pengesë ligjore për të votuar, nuk mund të abstenojnë. Kryetari voton i fundit.

2. Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve që marrin pjesë në mbledhje dhe kanë të drejtën e votës.

3. Në rastet kur rezultati i votimit është i barabartë, vota e kryetarit është vendimtare.

4. Anëtarët kanë të drejtë të shënojnë në procesverbal faktin dhe arsyet e votimit kundër një vendimi të marrë.

5. Në çdo mbledhje mbahet një procesverbal, në varësi edhe të natyrës së çështjeve të shqyrtuara në

mbledhjen e Komisionit. Procesverbal i mbledhjes përmban detyrimisht dhe në mënyrë të përmblodhur:

a) datën dhe orën e fillimit e të mbarimit të mbledhjes;

b) çështjet e shqyrtuara në rendin e ditës;

c) anëtarët e Komisionit të pranishëm;

ç) veprimet procedurale të zhvilluara në mbledhjen e Komisionit;

d) përmblodhjen e diskutimeve të anëtarëve;

dh) dispozitivin e vendimeve të Komisionit për çështjet që ishin pjesë e rendit të ditës; si dhe

e) çdo qëndrim tjetër, mbajtur gjatë punimeve të mbledhjes së Komisionit.

6. Procesverbal i mbahet nga sekretariati i Komisionit dhe u dërgohet për shqyrtim anëtarëve të Komisionit të pranishëm në mbledhje, të cilët, jo më vonë se 48 (dyzet e tetë) orë nga dita e nesërme e marrjes në dijeni, duhet të njoftojnë kryetarin, nëse kanë vërejtje për përmbajtjen e tij.

7. Procesverbal i përfundimtar u njoftohet të gjithë anëtarëve të Komisionit. Në rastet e kontestimeve nga anëtarët, procesverbal shqyrtohet dhe miratohet si çështje e parë e rendit të ditës në mbledhjen pasardhëse të Komisionit. Pas miratimit, procesverbal nënshkruhet nga kryetari dhe sekretariati i Komisionit.

KREU IV

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 9

Zgjedhja e anëtarëve, e zëvendëskryetarit dhe mbledhja e parë

1. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, titullarët e institucioneve, të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, dhe “dh”, të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 66/2023, “Për administrimin e objekteve të konfiskuara si ndërtime pa leje, me qëllim përdorimin e tyre për interes publik apo strehim social, si dhe zbutjen e pasojave sociale të shkaktuara”, i njoftojnë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës të dhënat për nëpunësit e nivelit të lartë drejtues, të caktuar prej tyre. Titullarët, sipas shkronjave “c”, “ç” dhe “d”, i njoftojnë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës të dhënat për një nëpunës, si anëtar të këtij Komisioni, në rast se e kanë autorizuar një të tillë.

2. Kryetari i Komisionit, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e marrjes së njoftimit nga titullari i



institucionit, që ka caktuar i fundit anëtarin e tij, thërret mbledhjen e parë të Komisionit.

3. Në mbledhjen e tij të parë të çdo viti kalendarik, Komisioni zgjedh zëvendëskryetarin me rotacion midis anëtarëve.

Neni 10

Raportimi i Komisionit

Komisioni ka detyrimin e raportimit periodik 3-mujor te ministri përgjegjës për administrimin e pronës shtetërore dhe te ministria përgjegjëse për zhvillimin urban.

Neni 11

Organet që ngarkohen me zbatimin e aktit

Ngarkohen Komisioni i Objekteve të Konfiskuara, Kryeministria, ministria përgjegjëse për administrimin e pronës shtetërore, ministria përgjegjëse për zhvillimin urban, Agjencia e Zhvillimit të Territorit, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, autoritet/et publik/e në cilësinë e njësisë së zbatimit dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

URDHËR

Nr. 75, datë 7.6.2024

PËR NGARKIM TË PËRKOHSHËM/ ZËVENDËSIM NË DETYRË

Bazuar në pikën 2 të nenit 104, nenet 118 dhe 119, të ligjit nr. 8417/1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, germën “d”, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, neneve 12, pika 2, 14, pika 4, si dhe 18, pika 3, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe

funksionimin e administratës shtetërore”, nenit 43, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe për shkak të vakancës së krijuar të pozicionit të punës të drejtorit të përgjithshëm të Tatimeve,

URDHËROJ:

1. Ngarkimin e përkohshëm nëpërmjet zëvendësimit, të zëvendës drejtorit të përgjithshëm të Hartimit të Programeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, znj. Elidjana Çelaj në detyrën e drejtorit të përgjithshëm të Tatimeve, me qëllim garantimin e funksionimit të veprimtarisë së përditshme administrative, deri në momentin e plotësimit të vakancës për këtë pozicion pune apo në një urdhër të dytë.

2. Çdo akt që bie në kundërshtim me këtë urdhër, shfuqizohet.

3. Ky urdhër nuk shoqërohet me efekte financiare.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet znj. Elidjana Çelaj dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në fletore zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE

Ervin Mete

URDHËR

Nr. 123, datë 5.6.2024

PËR MIRATIMIN E PLANIT VJETOR MINERAR 2024

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 6, germa “c” dhe nenit 8, pika 6, të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM-së nr. 380, datë 1.6.2022, “Për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar për vitet 2022–2024, në zbatim të strategjisë minerare”, VKM-së nr. 664, datë 10.10.2019, “Për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar, për vitet 2019–2021, në zbatim të strategjisë minerare”, VKM-së nr. 347, datë 29.4.2011, “Për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar për zbatimin e strategjisë minerare”, si dhe urdhrit të ministrit nr.



306, datë 13.4.2011, “Për procedurat dhe formën e hartimit të planit vjetor minerar”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e planit vjetor minerar për vitin 2024, sipas propozimeve të strukturave përgjegjëse AKBN-së (shkresa nr. 9797 prot., datë 18.12.2023) dhe SHGJSH-së (shkresa nr. 6703 prot., datë 17.8.2023).

2. Zonat minerare, për të cilat do të jepen lejet minerare, nëpërmjet procesit të konkurrimit apo

procedurave të hapura, janë të përcaktuara në aneksin 1 dhe aneksin 2, bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Ky urdhër hyn në fuqi të nesërmen e botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

ANEKSI 1

Nr.	Nr. i zonës	Bashkia	Qarku	TË DHËNA PËR VENDBURIMIN										KOORDINATAT E ZONËS		
				Vendburimi	Minerali	Rezerva gjeologjike ton/m ³	Cilësia	Lloji i veprimtarisë minerare	Lloji i zonës minerare	Sipërfaqja minimale km ²	Prodhimi minimal t/m ³ vit	Investimi minimal /000 euro	Sipërfaqja km ²	Pika	Y (Lindje)	X (Veri)
1	22/2	Himarë	Vlorë	Fahati Pilur	Gëlqeror	1,200,000	CaO 54.05%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	10,000	150	0.362	1	4396800	4442330
														2	4397260	4442160
														3	4397350	4442240
														4	4397600	4442150
														5	4397410	4441840
														6	4397140	4441920
														7	4396940	4441740
														8	4396480	4441960
2	22/29	Selenicë	Vlorë	Vodicë	Gëlqeror dekorativ	1,800,000	CaO 53.95%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	1,000	200	1.170	1	4376858	4475639
														2	4378153	4475639
														3	4378091	4476056
														4	4377938	4475989
														5	4377402	4476615
														6	4376403	4476579
3	22/30	Kurbini	Lezhë	Kumlati	Ranor pllakor	150,000	SiO2 53.50%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	1,000	200	0.063	1	4399211	4615771
														2	4399065	4615825
														3	4399004	4616060
														4	4399064	4616207
														5	4399193	4616172
														6	4399191	4615970
4	22/35	Librazhd	Elbasan	Dardha	Gëlqeror dekorativ	1,150,000	CaO 52%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	1,000	200	0.768	1	4445738	4555168
														2	4446136	4555635
														3	4446717	4555534
														4	4446967	4555227
														5	4446836	4554757
														6	4446214	4554751
5	22/43	Mirditë	Lezhë	Rrenjoll	Bakër	97,020	Cu 0.79%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	10,000	300	1.252	1	4419427	4626699
														2	4420034	4626949
														3	4420315	4626337
														4	4420495	4625914
														5	4419831	4625438
														6	4419318	4625251
6	22/46	Durrës	Durrës	Spitall	Ndërrimor (material mbushës)	260,000	SiO2 53%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	10,000	150	0.031	1	4368815	4580346
														2	4368744	4580561
														3	4368814	4580593
														4	4368790	4580630
														5	4368914	4580587
														6	4368914	4580382
7	22/48	Skrapar	Berat	Vërzhezdë	Ranor silicor pllakor	650,000	SiO2 55-65%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	1,000	200	0.074	1	4432126	4490526
														2	4432375	4490701
														3	4432566	4490468
														4	4432200	4490387
8	22/50	Skrapar	Berat	Koprençkë	Ranor silicor pllakor	5,400,000	SiO2 61%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	1,000	200	0.181	1	4440584	4478224
														2	4440513	4478226
														3	4440582	4478410
														4	4440605	4478586



														5	4440707	4478705
														6	4440810	4478784
														7	4441064	4478373
														8	4440888	4478237
														9	4440787	4478229
														10	4440702	4478257
9	22/51	Berat	Sevranimath	Sevranimath	Rancor silicor bllakor	3,300,000	SiO2 59%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	1,000	200	0.336	1	4441136	4472036
														2	4441187	4472277
														3	4441275	4472248
														4	4441490	4472311
														5	4441536	4472420
														6	4441642	4472509
														7	4441687	4472624
														8	4441951	4472829
														9	4442152	4472657
														10	4441913	4472336
														11	4441659	4472081
														12	4441350	4471998
10	22/52	Gjirokastrë	Gjirokastrë	Lazarat	Gëlqeror pllakor	1,200,000	CaO 50%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	1,000	200	0.165	1	4428523	4434516
														2	4428380	4434879
														3	4428757	4434810
														4	4429100	4434613
														5	4429248	4434479
														6	4429087	4434396
														7	4428702	4434657
11	22/56	Devoll	Korçë	Kapshticë	Konglo breckie	300,000	CaO 52.45%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	10,000	150	0.300	1	4503225	4499550
														2	4503225	4500150
														3	4503725	4500150
														4	4503725	4499550
12	22/57	Devoll	Korçë	Kapshticë	Konglo breckie	1,000,000	CaO 52.45%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	10,000	150	0.701	1	4502562	4498904
														2	4502785	4498828
														3	4503559	4499407
														4	4503791	4499008
														5	4503166	4498436
														6	4502635	4498124
13	22/58	Fier	Fier	Metalli 1	Argjilë	1,300,000	Al2O3 12% SiO2 45-47%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	10,000	150	0.285	1	4380801	4513246
														2	4381472	4512951
														3	4381199	4512464
														4	4381040	4512545
														5	4380469	4512985
														6	4380549	4513090
														7	4381175	4512803
														8	4381270	4512970
														9	4380791	4513173
14	22/59	Tepelenë	Gjirokastrë	Sinanaj	Gur dekorativ	2,800,000	CaO 52.5%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	1,000	200	1.309	1	4395349	4468581
														2	4395349	4469724
														3	4396494	4469724
														4	4396494	4468581
15	420/1	Himarë	Vlorë	Përroi i Vishës	Gëlqeror	890,000	CaO 53%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	10,000	150	0.100	1	4391807	4446019
														2	4392008	4446112
														3	4392216	4446780
														4	4391977	4446540
16	237	Lezhë	Lezhë	Vigu	Kaolinë	300,000	Al2O3 27- 29%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	10,000	150	0.824	1	4395322	4644085
														2	4395783	4644349
														3	4396016	4644333
														4	4396237	4643934
														5	4396396	4642996
														6	4396277	4642891
														7	4395951	4643130
														8	4395993	4643345
														9	4395913	4643451
														10	4395741	4643550
														11	4395508	4643498



ANEKSI 2

Nr.	Nr. i zonës	Bashkia	Qarku	TË DHËNA PËR VENDBURIMIN								KOORDINATAT E ZONËS		
				Emri i vendburimit	Lloji i mineralit	Rezerva gjeologjike, ton/m ³	Cilësia në %	Lloji i veprimtarisë minerare	Lloji i zonës minerare	Investimi minimal /000euro/km ²	Sipërfaqja e zonës (në km ²)	Pika	Y (Lindje)	X (Veri)
1	107/2	Tropojë	Kukës	Shkëmbi i Muratit - Shpati i Sukës	Bakër	-	-	Kërkim-zbulimi	E hapur	20	7.057	1	4430415	4677666
												2	4430820	4676706
												3	4432328	4676186
												4	4435084	4678145
												5	4434357	4678892
												6	4432820	4678722
2	164/3	Vau i Dejës	Shkodër	Mnelë	Bakër	-	-	Kërkim-zbulimi	E hapur	20	9.325	1	4396318	4646846
												2	4395529	4646492
												3	4394775	4647872
												4	4389864	4651960
												5	4390449	4652659
												6	4392669	4650937
												7	4395608	4649354
												8	4395883	4647646
3	587/2	Pukë	Shkodër	Lugu i Kumbullës	Krom	-	-	Kërkim-zbulimi	Konkurreuese	20	1.500	1	4409707	4652628
												2	4409037	4652129
												3	4409794	4650843
												4	4410745	4651567
4	698/2	Kukës	Shkodër	T'Pla	Krom	-	-	Kërkim-zbulimi	Konkurreuese	20	2.415	1	4427445	4683412
												2	4426446	4683813
												3	4426446	4684185
												4	4425314	4684185
												5	4425314	4684626
												6	4425609	4684818
												7	4425703	4685423
												8	4426824	4685423
												9	4427012	4684520
												10	4427445	4684132

URDHËR

Nr. 319, datë 10.6.2024

PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 432, DATË 30.6.2023, TË MINISTRIT TË DREJTËSISË “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR ORGANIZIMIN, ZHVILLIMIN, PËRMBAJTJEN E PROVIMIT TË PRANIMIT, SI DHE PROCEDURËN E VLERËSIMIT DHE SHPALLJES SË REZULTATEVE PËR PËRMBARUESIN GJYQËSOR SHTETËROR”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës; të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar; si dhe të nenit 17, pika 5, të ligjit nr. 8/2023, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”,

URDHËROJ:

Neni 1

1. Në pikën 1 të nenit 4, togfjalëshi “brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e publikimit të

thirrjes” zëvendësohet me “brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e publikimit të thirrjes”.

Neni 2

Në nenin 5 bëhen ndryshimet si vijon:

1. Në pikën 2, togfjalëshi “brenda 10 (dhjetë) ditëve nga përfundimi i afatit” zëvendësohet me “brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i afatit”.

2. Në pikën 3, togfjalëshi “brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e njoftimit” zëvendësohet me “brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit”.

3. Në pikën 4, togfjalëshi “brenda 10 (dhjetë) ditëve nga përfundimi i procedurës” zëvendësohet me “brenda 3 (tri) ditëve nga përfundimi i procedurës”.

Neni 3

Neni 6 ndryshohet si vijon:

1. Në pikën 1, togfjalëshi “jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë”, zëvendësohet me “jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë”.



2. Në pikën 3 togfjalëshi “jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë”, zëvendësohet me “jo më vonë se 5 (pesë) ditë”.

Neni 4

Në pikën 1 të nenit 19, togfjalëshi “jo më vonë se 2 (dy) javë” zëvendësohet me “jo më vonë se 1 (një) javë”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

NJOFTIM
Nr. 9035, datë 11.6.2024

MBI HYRJEN NË FUQI TË NJË MARRËVESHJEJE DYPALËSHE

Marrëveshja ndërkombëtare e bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kolegjit të Evropës për hapjen e degës së Kolegjit të Evropës në Tiranë, nënshkruar më 8.2.2024, në Tiranë, ka hyrë në fuqi më datë 15.5.2024.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

URDHËR
Nr. 91, datë 11.6.2024

PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM KOMPETENCASH

Në mbështetje dhe në zbatim të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 12, pika 1, dhe nenit 13, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të nenit 7, pika 2, germa “c” e rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, në mungesë të kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, gjyqtarës Mimoza Tasi, për periudhën nga data 13.6.2024 deri më 21.6.2024. Kjo kompetencë nuk mund të nëndelegohet.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet gjyqtarja Mimoza Tasi dhe të gjithë punonjësit e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KOLEGJIT TË POSAÇËM TË
APELIMIT
Sokol Çomo

VENDIM (i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, me vendimin nr. 41-2024-1137-323, datë 28.3.2024, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Ada Lako, e datëlindjes 18.9.1976, lindur dhe banuese në Korçë, si dhe vendosjen e saj nën kujdestarinë e të vëllait, shtetasit Fabian Lako.

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 128 lekë